

Shfrytëzimi ilegal i rërës dhe zhavorrit nga lumenjtë dhe degradimi i ekosistemeve lumore

Korrik, 2026



AUTORË:

Visar Rushiti dhe Marigona Berisha



Vizitoni webfaqen tonë
www.dplus.org

Zbuloni më shumë për publikimin tonë të fundit,
lajmet, infografikat online.



Na gjeni në Facebook
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Na gjeni në LinkedIn
[@democracy-plus](https://www.linkedin.com/company/democracy-plus)



Na gjeni në Twitter
[@democracy_plus](https://twitter.com/democracy_plus)



Na gjeni në Youtube
[@DemocracyPlus](https://www.youtube.com/DemocracyPlus)

Zyrat tona:

Rruga Bajram Kelmendi, Nr.92, Kati IV
Prishtinë, 10000
Kosovë

+383 (0) 38 749 288
info@dplus.org

Përmbledhje ekzekutive

Ky hulumtim analizon sfidat në parandalimin dhe trajtimin e shfrytëzimit ilegal të rërës dhe zhavorrit nga lumenjtë në Kosovë. Gjetjet tregojnë se, ndonëse ekziston një bazë e mirë ligjore, zbatimi i saj vazhdon të kufizohet nga mungesa e kapaciteteve institucionale, koordinimi i pamjaftueshëm ndërinstitutional dhe sfidat në procedurat gjyqësore.

Analiza bazohet në analizën e legjislacionit, dokumenteve strategjike, intervistave, fokus grupit, diskutimit tematik me institucionet përgjegjëse dhe ekspertët e fushës, konsultimeve me qytetarë dhe analizës së praktikës gjyqësore.

- Sipërfaqja e degraduar përgjatë lumenjve është rritur nga 1,762.71 hektarë në vitin 2018 në 2,059.96 hektarë në vitin 2024, ndërsa Drini i Bardhë mbetet lumi më i prekur, me dëmtime të konsiderueshme të shtratit dhe brigjeve të tij;
- Ligji për Ujërat parasheh që përcaktimi i segmenteve ku mund të lejohet nxjerrja e rërës dhe zhavorrit të bëhet në harmoni me Strategjinë Shtetërore të Ujërave. Mirëpo, Strategjia Shtetërore për Ujëra 2023–2027 (tutje: Strategjia) nuk i identifikon këto segmente, por parashikon që ato të përcaktohen me vendim të ministrit përgjegjës;
- Plani i Veprimit 2023–2025 parasheh dy masa kryesore: (i) hartimin e një plani të veçantë për menaxhimin e shfrytëzimit të lumenjve; dhe (ii) përcaktimin, me vendim të ministrit, të segmenteve lumore ku mund të lejohet nxjerrja e rërës dhe zhavorrit. Sidoqoftë, asnjëra nga këto dy masa të parashikuara në Planin e Veprimit ende nuk janë zbatuar nga institucionet përgjegjëse;
- Strategjia parasheh rritjen e numrit të inspektorëve të ujërave nga tre (3) në tetë (8), me qëllim forcimin e mbikëqyrjes së burimeve ujore. Megjithatë, ky objektivi nuk është realizuar. Aktualisht, në Departamentin e Inspektoratit të Mjedisit dhe Ujërave në kuadër të ministrisë përgjegjëse janë të angazhuar gjithsej tre (3) inspektorë, prej të cilëve dy (2) janë inspektorë të ujërave dhe një (1) është i profilizuar për industrinë;
- Përveç rritjes së numrit të inspektorëve, Strategjia parasheh edhe rritjen graduale të numrit të inspektimeve me 30% deri në vitin 2025 dhe me 50% deri në vitin 2027. Mirëpo, për shkak të mungesës së të dhënave mbi numrin bazë të inspektimeve dhe realizimin e këtij objekti, nuk ishte e mundur të vlerësohej progresi në zbatimin e kësaj mase;
- Komunat nuk kanë inspektorë të specializuar për ujërat, ndërsa inspektorët komunalë të mjedisit rrallë angazhohen në trajtimin e rasteve të shfrytëzimit ilegal të rërës dhe zhavorrit nga lumenjtë. Si rrjedhojë, monitorimi i vazhdueshëm i lumenjve nuk arrin të mbulojë të gjitha zonat, ndërsa reagimi ndaj rasteve të shfrytëzimit ilegal shpesh ndodh vetëm pasi ato raportohen;
- Sfida paraqiten edhe në monitorimin e krimeve mjedisore. Njësia për Hetimin e Krimeve Mjedisore në kuadër të Policisë së Kosovës aktualisht ka vetëm një (1) mbikëqyrës dhe dy (2) hetues të specializuar, ndërsa në nivel lokal nuk ka hetues të specializuar për këtë fushë. Kjo e vështirëson monitorimin dhe hetimin e rasteve të shfrytëzimit ilegal të rërës dhe zhavorrit;
- Trajtimi i shfrytëzimit ilegal të rërës dhe zhavorrit nga lumenjtë dhe brigjet e tyre kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Aktualisht, koordinimi ndërinstitutional vazhdon të mbështetet kryesisht në mekanizma të përkohshëm, pa një koordinim të përhershëm që do të siguronte bashkëpunim të qëndrueshëm dhe reagim të shpejtë ndaj rasteve të shfrytëzimit ilegal;

- Shembull i mirë i koordinimit ndërinstitucional ishte Task Forca e Gjelbër, e themeluar në vitin 2024 me iniciativë të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse. Gjatë funksionimit të saj, ky mekanizëm realizoi mbi 30 aksione të përbashkëta, me 24 gjoba administrative të shqiptuara, 23 raste të referuara në Policinë e Kosovës për procedim penal dhe 30 mjete të sekuestruara me vlerë rreth 2 milion euro;
- Edhe pse Ligji për Ujërat parasheh funksionimin e Këshillit Ndërmintor për Ujëra si mekanizëm koordinues, gjatë këtij hulumtimi u konstatua se ai nuk ka qenë funksional për disa vite;
- Të dhënat e siguruara nga shtatë prokuroritë themelore tregojnë se rastet e shfrytëzimit ilegal të rrës dhe zhavorrit procedohen rregullisht. Gjatë periudhës 2023 - 2025 janë regjistruar 184 kallëzime penale, ndërsa për 137 prej tyre janë ngritur aktakuza, çka tregon se një pjesë e konsiderueshme e rasteve kanë kaluar në fazën e gjyqimit;
- Gjobat shpesh janë të ulëta në raport me dëmin e shkaktuar dhe përfitimin ekonomik që mund të realizohet nga aktiviteti ilegal. Kjo vërehet edhe në aktgjykimet e shqyrtuara, ku janë shqiptuar gjoba prej 250 deri në 500 euro për dëme shumë të mëdha të shkaktuara në mjedis;
- Një nga vështirësitë kryesore në trajtimin e këtyre rasteve lidhet me konfiskimin e mjeteve të përdorura për shfrytëzimin ilegal të rrës dhe zhavorrit. Edhe kur prokuroria kërkon konfiskimin e ekskavatorëve ose kamionëve, gjykatat nuk i miratojnë gjithmonë këto kërkesa. Për shembull, në aktgjykimin P.nr.49/2026 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, gjykata refuzoi konfiskimin e një ekskavatori dhe një kamioni, duke vlerësuar se vlera e tyre ishte joproporcionale në raport me dëmin e konstatuar.
- Transportimi i mjeteve të rënda kërkon angazhimin e operatorëve të specializuar dhe shoqërohet me kosto të larta. Në një rast, transporti i një makinerie nga Zveçani në Prishtinë ka kushtuar rreth 3,500 euro. Po ashtu, në disa raste mjetet dëmtohen qëllimisht para sekuestrimit, duke e bërë edhe më të vështirë transportimin dhe ruajtjen e tyre;
- Vështirësi reflektohen edhe në mënyrën se si vlerësohet dëmi gjatë procedurës gjyqësore. Vëmendja përqendrohet kryesisht te dëmi ekonomik, ndërsa ndikimi afatgjatë në lumenj dhe ekosistemet e tyre nuk reflektohet gjithmonë në mënyrë të plotë. Kështu, dëmi ekologjik nuk pasqyrohet gjithmonë në masën e sanksioneve që shqiptohen;

Përkufizimi i problemit

Shfrytëzimi ilegal i rërës dhe zhavorrit vazhdon të shkaktojë dëme të konsiderueshme në ekosistemet lumore në Kosovë. Kur këto materiale nxirren në mënyrë të pakontrolluar nga lumenjtë dhe brigjet e tyre, ndryshohet rrjedha dhe shtrati natyror i lumenjve, përshpejtohet erozioni i brigjeve, dëmtohen habitatet natyrore dhe rritet rreziku i vërshimeve gjatë reshjeve intensive. Pasojat nuk ndihen vetëm në mjedis, por edhe nga komunitetet që jetojnë pranë lumenjve, përmes dëmtimit të tokave bujqësore, infrastrukturës dhe mjedisit ku jetojnë.

Pavarësisht masave të ndërmarra ndër vite, degradimi i lumenjve nga shfrytëzimi ilegal i rërës dhe zhavorrit mbetet një problem serioz. Sipërfaqja e degraduar përgjatë lumenjve është rritur nga 1,762.71 hektarë në vitin 2018 në 2,059.96 hektarë në vitin 2024, ndërsa Drini i Bardhë mbetet lumi më i prekur, me dëmtime të konsiderueshme të shtratit dhe brigjeve të tij¹. Rritja e sipërfaqes së degraduar tregon se shfrytëzimi ilegal vazhdon dhe se masat e ndërmarra deri më tani nuk kanë qenë të mjaftueshme për ta ndalur këtë dukuri. Në disa segmente lumore, intensiteti i shfrytëzimit ka tejkaluar kapacitetin natyror të lumenjve për rikuperim, duke e bërë rehabilitimin e zonave të degraduara gjithnjë e më të vështirë².

Përveç dëmit mjedisor, kjo dukuri krijon përfitime të konsiderueshme ekonomike për operatorët ilegalë, ndërsa koston e degradimit e bartin institucionet dhe qytetarët.

Kosova ka një bazë të mirë ligjore për mbrojtjen e lumenjve dhe rregullimin e nxjerrjes së rërës dhe zhavorrit. Ligji për Ujëra e ndalon nxjerrjen e materialeve inerte nga lumenjtë, përveç rasteve të veçanta kur lejohet me leje ujore, ndërsa dokumentet strategjike parashohin masa për monitorimin dhe mbrojtjen e resurseve ujore. Megjithatë, intervistat me institucionet përgjegjëse, ekspertët e fushës, diskutimet në fokus grup dhe konsultimet me qytetarë, tregojnë se problemi kryesor nuk është mungesa e legjislacionit, por zbatimi i tij në praktikë.

Analiza e këtij hulumtimi identifikon tri probleme kryesore që kufizojnë reagimin institucional ndaj shfrytëzimit ilegal të rërës dhe zhavorrit nga lumenjtë dhe brigjet e tyre:

- **Mungesa e kapaciteteve inspektuese dhe monitoruese**, që e bën të vështirë mbikëqyrjen e lumenjve dhe reagimin në kohë ndaj aktiviteteve ilegale.
- **Koordinimi i pamjaftueshëm ndërinstitutional**, që vështirëson bashkërendimin e veprimeve ndërmjet institucioneve përgjegjëse.
- **Sfidat në procedurën gjyqësore**, përfshirë konfiskimet e rralla të makinerive dhe gjobot e ulëta në raport me dëmin e shkaktuar.

Këto çështje trajtohen në kapitujt vijues me synimin për të identifikuar sfidat kryesore në zbatimin e legjislacionit dhe për të propozuar masa konkrete që do të forconin mbrojtjen e lumenjve dhe ekosistemeve lumore nga shfrytëzimi ilegal i rërës dhe zhavorrit.

1 Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), Raport: Degradimi i Shtretërve të Lumenjve 2018–2024, Prishtinë, 2026, i qasshëm në: <https://www.ammk-rks.net/al/lajmi-single/925>

2 Diskutim në fokus grup me akterë relevantë nga institucionet përgjegjëse dhe ekspertë të fushës, mbajtur më 23.06.2026.

Korniza ligjore

Ligji për Ujërat është ligji bazë që rregullon mbrojtjen dhe menaxhimin e resurseve ujore në Kosovë, përfshirë edhe parandalimin dhe kontrollin e nxjerrjes së rërës dhe zhavorrit nga lumenjtë nga persona fizikë dhe juridikë³. Sipas nenit 48, me qëllim të mbrojtjes së lumenjve, ndalohet nxjerrja e rërës, zhavorrit dhe gurëve nga lumenjtë, liqenet dhe brigjet e tyre⁴. Përrjashtimisht, ligji lejon nxjerrjen e këtyre materialeve vetëm në kushtet, mënyrën dhe procedurat e përcaktuara me ligj.

Në këtë kuadër, neni 56 përcakton se nxjerrja e rërës dhe zhavorrit mund të lejohet vetëm në segmente të caktuara të lumenjve dhe vetëm kur ajo shërben për mbrojtjen e regjimit të ujërave, shtratit dhe brigjeve të lumit⁵. Për zhvillimin e këtij aktiviteti kërkohet pajisja me leje ujore, ndërsa neni 72 përcakton se leja ujore lëshohet, ndër të tjera, edhe për shfrytëzimin e rërës, zhavorrit, gurit dhe argjilit⁶. Sipas Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore (ARPL), aktualisht nuk ka asnjë leje ujore aktive për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit nga lumenjtë⁷.

Për zbatimin e këtyre dispozitave janë miratuar një sërë aktesh nënligjore. Për fushën e trajtuar në këtë analizë, rëndësi të veçantë ka Udhëzimi Administrativ për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e brigjeve të ujërrjedhave dhe akumulacioneve, i cili përcakton kushtet, kriteret dhe procedurat për nxjerrjen e rërës dhe zhavorrit në lumenj dhe brigjet e tyre, me qëllim mbrojtjen e shtratit të lumit, brigjeve dhe ekosistemeve lumore⁸.

Në nivel strategjik, Ligji për Ujërat parasheh që përcaktimi i segmenteve ku mund të lejohet nxjerrja e rërës dhe zhavorrit të bëhet në harmoni me Strategjinë Shtetërore të Ujërave⁹. Mirëpo, Strategjia Shtetërore për Ujëra 2023–2027 (tutje: Strategjia) nuk i identifikon këto segmente, por parashikon që ato të përcaktohen me vendim të ministrit përgjegjës. Për këtë qëllim, Plan i Veprimit 2023–2025 parasheh dy masa kryesore: (i) hartimin e një plani të veçantë për menaxhimin e shfrytëzimit të lumenjve; dhe (ii) përcaktimin, me vendim të ministrit, të segmenteve lumore ku mund të lejohet nxjerrja e rërës dhe zhavorrit¹⁰. Sidoqoftë, asnjëra nga këto dy masa të parashikuara në Planin e Veprimit ende nuk janë zbatuar nga institucionet përgjegjëse¹¹.

Përveç Ligjit për Ujërat, mbrojtja e lumenjve mbështetet edhe në akte të tjera ligjore, ndër të cilat më të rëndësishmet janë Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit¹², i cili përcakton parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, si dhe Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis¹³, i cili kërkon vlerësim paraprak për aktivitetet që mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në mjedis. Po ashtu, neni 338 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës krijon bazën ligjore për ndjekjen penale të veprimeve që shkaktojnë ndotje, degradim ose shkatërrim të mjedisit¹⁴.

3 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659>

4 Po aty, neni 48.

5 Po aty, neni 56.

6 Po aty, neni 72.

7 Intervistë me Fatlije Buzën, Udhëheqëse e Divizionit për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore, Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (ARPL), MMPH, 05.05.2026.

8 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Udhëzim Administrativ (MMPH) Nr. 04/2016 për Kriteret dhe Procedurat për Mbrojtjen e Brigjeve të Ujërredhave dhe Akumulacioneve, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12849>

9 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Rishikimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023–2027 dhe Plan i Veprimit 2023–2025, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=78647>

10 Po aty, Tabela III.3.1 dhe III.3.2, f. 56, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=78647>

11 Komunikim përmes emailit me Fatlije Buzën, Udhëheqëse e Divizionit për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore, Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (ARPL), MMPH, 09.06.2026.

12 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2631>

13 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68708>

14 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 338, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413>

Mangësitë në kornizën ligjore

Edhe pse korniza ligjore ofron bazë të mjaftueshme për mbrojtjen e lumenjve dhe rregullimin e nxjerrjes së rërës dhe zhavorrit, disa çështje vazhdojnë të krijojnë vështirësi në zbatimin e saj.

- **Harmonizimi i Ligjit për Ujërat me legjislacionin e Bashkimit Evropian.** Drafti i ri i Ligjit për Ujërat, i cili është në proces harmonizimi me Direktivën Kornizë për Ujërat (2000/60/EC), krijon mundësi për të adresuar disa nga boshllëqet e evidentuara gjatë zbatimit të legjislacionit aktual.
- **Rregullimi përmes akteve nënligjore.** Disa çështje të rëndësishme, si përcaktimi i segmenteve ku mund të lejohet nxjerrja e rërës dhe zhavorrit, vazhdojnë të rregullohen përmes akteve nënligjore. Kjo ka krijuar paqartësi në zbatim dhe interpretime të ndryshme nga institucionet përgjegjëse.

■ **Trajtimi penal i rasteve të shfrytëzimit ilegal.**

Këto raste trajtohen në kuadër të veprës penale të dëmtimit të mjedisit, pasi legjislacioni nuk përmban dispozita të veçanta për shfrytëzimin ilegal të rërës dhe zhavorrit. Për pasojë, edhe në Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), ato evidentohen në kuadër të kategorisë së përgjithshme “Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit” dhe jo si kategori e veçantë. Kjo e vështirëson identifikimin, monitorimin dhe analizimin e praktikës gjyqësore për rastet e shfrytëzimit ilegal të rërës dhe zhavorrit.

Megjithëse korniza ligjore krijon bazë të mjaftueshme për mbrojtjen e lumenjve, gjetjet e hulumtimit tregojnë se sfidat kryesore lidhen me kapacitetet institucionale, koordinimin ndërinstitutional dhe trajtimin e rasteve në procedurat penale dhe gjyqësore. Këto çështje trajtohen në kapitujt vijues.

2018

386

inspektime me
procesverbal

140

vendime për
ndërprerjen e
punimeve

206

vendime për
shqiptimin e
gjobave

28

raste në
gjykatë

Janë

sequestruar

62

mjete motorike

22

separacione
të rërës dhe
zhavorrit

2025

17

persona
janë
arrestuar

Kapacitetet e kufizuara inspektuese dhe monitoruese

Edhe pse mbrojtja e lumenjve nga shfrytëzimi ilegal i rërës dhe zhavorrit është identifikuar si prioritet në dokumentet strategjike, institucionet përgjegjëse vazhdojnë të përballen me mungesë të kapaciteteve për inspektim dhe monitorim. Kjo e bën të vështirë mbulimin efektiv të territorit, mbikëqyrjen e vazhdueshme të lumenjve dhe reagimin në kohë ndaj aktiviteteve ilegale.

Strategjia parasheh rritjen e numrit të inspektorëve të ujërave nga tre (3) në tetë (8), me qëllim forcimin e mbikëqyrjes së burimeve ujore¹⁵. Megjithatë, ky objektiv nuk është realizuar. Aktualisht, në Departamentin e Inspektoratit të Mjedisit dhe Ujërave në kuadër të ministrisë përgjegjëse janë të angazhuar gjithsej tre (3) inspektorë, prej të cilëve dy (2) janë inspektorë të ujërave dhe një (1) është i profilizuar për industrinë. Me vetëm dy inspektorë të ujërave, inspektimi i vazhdueshëm i lumenjve dhe reagimi në kohë ndaj rasteve të shfrytëzimit ilegal mbeten sfida.

Mungesa e inspektorëve nuk është sfida e vetme me të cilën përballen Inspektorati. Ligji për Inspektoratin Qendror kishte paraparë krijimin e një agjencie, shtimin e stafit profesional dhe mbështetës, si dhe digjitalizimin e proceseve të inspektimit, por pas shfuqizimit të tij nga Gjykata Kushtetuese, këto ndryshime nuk janë funksionalizuar. Po ashtu, mungesa e stafit administrativ dhe mbështetës vazhdon të ndikojë në funksionimin e përditshëm të inspektoratit¹⁶.

Përveç rritjes së numrit të inspektorëve, Strategjia parasheh edhe rritjen graduale të numrit të inspektimeve me 30% deri në vitin 2025 dhe me 50% deri në vitin 2027¹⁷. Mirëpo, për shkak të mungesës së të dhënave vjetore dhe të një numri bazë të përcaktuar të inspektimeve, nuk ishte e mundur të vlerësohej progresi në realizimin e këtij objektiv.

Të dhënat e Inspektoratit për periudhën 2018–2025 janë ndërmarrë një numër i konsiderueshëm veprimesh në terren. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 386 inspektime me procesverbal, janë nxjerrë 140 vendime për ndërprerjen e punimeve dhe 206 vendime për shqiptimin e gjobave. Po ashtu, janë iniciuar 28 raste në gjykatë, janë sekuestruar 62 mjete motorike dhe 22 separacione të rërës dhe zhavorrit, ndërsa janë arrestuar 17 persona¹⁸.

Këto të dhëna tregojnë se, megjithëse janë ndërmarrë veprime nga Inspektorati, rritja e sipërfaqes së degraduar përgjatë lumenjve sugjeron se ato nuk kanë qenë të mjaftueshme për ta ndaluar degradimin.

Mbikëqyrja e pamjaftueshme nuk kufizohet vetëm te aktivitetet ilegale. Edhe një pjesë e operatorëve që ushtrojnë aktivitetet në bazë të lejeve devijojnë nga kushtet e tyre, çka tregon se kontrolli i tyre nuk është i mjaftueshëm¹⁹.

15 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Rishikimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023–2027 dhe Plani i Veprimit 2023–2025, Treguesit për Objektivin Specifik 1.3, f. 27, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=78647>

16 Intervistë me Ademi Berisha dhe Elbasan Shala, Inspektoratit për Mjedis, Ujëra dhe Natyrë, Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (MMPH), 15.05.2026.

17 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Rishikimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023–2027 dhe Plani i Veprimit 2023–2025, Treguesit për Objektivin Specifik 3.3, f. 33, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=78647>

18 MMPH, Inspektorati i Mjedisit, Ujërave dhe Natyrës, të dhëna të dorëzuara gjatë takimit, 15.05.2026.

19 Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), Raport: Degradimi i Shtretërve të Lumenjve 2018–2024, Prishtinë, 2026, i qasshëm në: <https://www.ammk-rks.net/al/lqjmi-single/925>

Këto kufizime pasqyrohen edhe në mënyrën se si organizohet mbikëqyrja në terren. Inspektimet realizohen kryesisht në bazë të planeve vjetore të punës, zakonisht dy deri në tri herë në vit në zona të caktuara, si dhe pas raportimeve ose ankesave të qytetarëve. Aktivitetet ilegale zhvillohen më së shpeshti gjatë natës, në orët e hershme të mëngjesit ose gjatë fundjavave, kur mbikëqyrja institucionale është më e kufizuar. Për më tepër, kryerja e inspektimeve jashtë orarit të rregullt të punës kërkon miratim paraprak administrativ, duke kufizuar mundësinë e reagimit të shpejtë²⁰.

Probleme të ngjashme hasen edhe në nivel lokal. Komunitat nuk kanë inspektorë të specializuar për ujërat, ndërsa inspektorët komunalë të mjedisit rrallë angazhohen në trajtimin e rasteve të shfrytëzimit ilegal të rërës dhe zhavorrit nga lumenjtë. Si rrjedhojë, monitorimi i vazhdueshëm i lumenjve nuk arrin të mbulojë të gjitha zonat, ndërsa reagimi ndaj rasteve të shfrytëzimit ilegal shpesh ndodh vetëm pasi ato raportohen.

Përveç kapaciteteve të kufizuara inspektuese, sfida paraqiten edhe në monitorimin e krimeve mjedisore. Njësia për Hetimin e Krimeve Mjedisore në kuadër të Policisë së Kosovës aktualisht ka vetëm një (1) mbikëqyrës dhe dy (2) hetues të specializuar, ndërsa në nivel lokal nuk ka hetues të specializuar për këtë fushë. Kjo e vështirëson monitorimin dhe hetimin e rasteve të shfrytëzimit ilegal të rërës dhe zhavorrit.

Në këto rrethana, edhe kontributi i qytetarëve në identifikimin e rasteve merr rëndësi të veçantë. Ky hulumtim tregon se shumica e qytetarëve që kanë vërejtur raste të shfrytëzimit ilegal nuk i kanë raportuar ato tek institucionet përgjegjëse²¹. Kjo tregon nevojën për promovimin më të madh të mekanizmave ekzistues të raportimit dhe inkurajimin e qytetarëve për t'i përdorur ato. Në këtë drejtim, institucionet kanë ndërmarrë disa hapa pozitivë, përfshirë lansimin e iniciativës "Raportimi i Gjelbër"²² përfshirë iniciativën "Raporto Krimet Mjedisore"²³, e cila u mundëson qytetarëve të raportojnë shkeljet mjedisore.

20 Diskutim në fokus grup me aktorë relevantë nga institucionet përgjegjëse dhe ekspertë të fushës, mbajtur më 23.06.2026.

21 Pyetësor anonim me qytetarë, i realizuar përmes platformës CER (Citizen Engagement Response), qershor 2026.

22 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, "Raportimi i Gjelbër", 22 prill 2025, i qasshëm në: <https://mmphi.rks-gov.net/Neës/NeësArticle?ArticleID=2472>

23 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, njoftim për integrimin e vegzës "Krime Mjedisore" në aplikacionin "Lajmëro Policinë", 07.05.2026.

Koordinimi i pamjaftueshëm ndërinstitutional

Trajtimi i shfrytëzimit ilegal të rërës dhe zhavorrit nga lumenjtë dhe brigjet e tyre kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Aktualisht, koordinimi ndërinstitutional vazhdon të mbështetet kryesisht në mekanizma të përkohshëm, pa një koordinim të përhershëm që do të siguronte bashkëpunim të qëndrueshëm dhe reagim të shpejtë ndaj rasteve të shfrytëzimit ilegal.

Në këtë proces, rol qendror ka Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), përmes Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore (ARPL) dhe Inspektoratit të Mjedisit, Ujërave dhe Natyrës, si dhe Policia e Kosovës, Prokuroria e Shtetit dhe Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM).

Një shembull i mirë i koordinimit ndërinstitutional ishte Task Forca e Gjellbër, e themeluar në vitin 2024 me iniciativë të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse²⁴. Gjatë funksionimit të saj, ky mekanizëm realizoi mbi 30 aksione të përbashkëta dhe mundësoi koordinimin e veprimeve ndërmjet institucioneve përgjegjëse për identifikimin dhe trajtimin e rasteve të shfrytëzimit ilegal të rërës dhe zhavorrit nga lumenjtë dhe brigjet e tyre. Gjatë veprimeve të Task Forcës u sekuestruan edhe mjete dhe pajisje të përdorura për shfrytëzimin ilegal, përfshirë ekskavatorë, kamionë, lugë ngarkuese, separacione, gurthyes dhe një kamion automikser. Rezultatet kryesore të këtij mekanizmi paraqiten në Tabelën 1²⁵.

TABELA 01. Rezultatet e Task Forcës së Gjellbër në trajtimin e shfrytëzimit ilegal të rërës dhe zhavorrit nga lumenjtë dhe brigjet e tyre (2024)

Tregues	Rezultati
Periudha e funksionimit	Viti 2024
Raste të trajtuara	29
Gjoha administrative të shqiptuara	24
Raste të referuara në Policinë e Kosovës për procedim penal	23
Mjete të sekuestruara (eskavatorë, kamionë, separatorë, lugë ngarkuese, etj.).	30

Burimi: MMPH, Inspektorati i Mjedisit, Ujërave dhe Natyrës

²⁴ Sipas njoftimit të MMPH-së, Task Forca e Gjellbër është themeluar me vendim të ministrit përgjegjës. Vendimi nuk është publikuar në faqen zyrtare të MMPH-së apo në Gazetën Zyrtare.

²⁵ MMPH, Inspektorati i Mjedisit, Ujërave dhe Natyrës, të dhëna të dërguara përmes emailit, 04.06.2026.

Sipas Policisë së Kosovës, gjatë aksioneve të Task Forcës së Gjelbër janë sekuestruar makineri me vlerë të përafërt prej rreth 2 milionë eurosh²⁶. Këto rezultate tregojnë se institucionet përgjegjëse janë në gjendje të bashkëpunojnë dhe të arrijnë rezultate konkrete kur veprojnë në mënyrë të koordinuar. Mirëpo, ky nivel bashkëpunimi u arrit vetëm gjatë funksionimit të Task Forcës. Pas përfundimit të mandatit të saj, institucionet vazhduan të ushtrorin njëjtat kompetenca, por pa ruajtur të njëjtin nivel koordinimi. Kjo tregon se sfida nuk lidhet me mungesën e institucioneve apo të kompetencave, por me mungesën e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve që tashmë kanë përgjegjësi të përcaktuara me ligj.

Edhe pse Ligji për Ujërat parasheh funksionimin e Këshillit Ndërmënyës për Ujëra si mekanizëm koordinues, gjatë këtij hulumtimi u konstatua se ai nuk ka qenë funksional për disa vite²⁷. Mungesa e funksionalizimit të këtij mekanizmi tregon se koordinimi ndërinstitucional në këtë fushë nuk ka marrë vëmendjen e nevojshme institucionale dhe politike.

Një tjetër sfidë lidhet me ndarjen e kompetencave ndërmjet MMPH-së dhe KPMM-së, veçanërisht në rastet kur nxjerrja e rërës dhe zhavorrit ndërthuret me shfrytëzimin e resurseve minerare. Në praktikë, përgjegjësitë e MMPH-së lidhen me zonën deri në 150 metra nga shtrati i lumit, ndërsa përtej kësaj distance përgjegjësitë kalojnë te KPMM-ja²⁸. Në rastet e shfrytëzimit ilegal, kjo ndarje nuk është gjithmonë e qartë, sidomos kur mungojnë vijëzime të qarta në terren dhe aktivitetet zhvillohen përtej kufijve të përcaktuar me ligj. Si rezultat, mund të krijohen paqartësi lidhur me institucionin përgjegjës për ndërhyrje, duke e bërë më të vështirë koordinimin dhe zbatimin efektiv të legjislacionit.

Një aspekt tjetër i koordinimit ndërinstitucional lidhet me ndarjen e kompetencave ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal. Ligji për Ujërat përcakton se komunat janë përgjegjëse për mbrojtjen e ujërrjedhave dhe objekteve ujore brenda zonave urbane, ndërsa ARPL jashtë tyre²⁹. Kjo ndarje e kompetencave e bën të domosdoshëm koordinimin ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal, pasi mungesa e tij mund të vonojë reagimin institucional dhe ta bëjë më të vështirë trajtimin efektiv të rasteve të shfrytëzimit ilegal.

26 Intervistë me Arsim Krasniqin, Drejtor i Drejtorisë së Hetimit të Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, 12.06.2026.

27 Intervistë me Afrim Lajçin, ekspert i ujërave, 20.05.2026.


28 Intervistë me Haradin Gërvallën, U.D. Drejtor i Përgjithshëm, Refki Morinën, Kryeinspektor, dhe Mentor Sylmetën, Zyrtar Ligjor, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), 20.05.2026.

29 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, nenet 49 dhe 51, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659>

Sfidat në procedurën gjyqësore

Edhe kur rastet e shfrytëzimit ilegal të rërës dhe zhavorrit zbulohen dhe procedohen në gjykatë, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se ato përfundojnë me sanksione që i dekurajojnë shkelësit të përsërisin të njëjtin aktivitet ilegal. Mënyra se si trajtohen këto raste ka rëndësi të madhe për parandalimin e shfrytëzimit ilegal.

Të dhënat e siguruar nga shtatë prokuroritë themelore tregojnë se rastet e shfrytëzimit ilegal të rërës dhe zhavorrit procedohen rregullisht. Gjatë periudhës 2023 - 2025 janë regjistruar 184 kallëzime penale, ndër- sa për 137 prej tyre janë ngritur aktakuza, çka tregon se një pjesë e konsiderueshme e rasteve kanë kaluar në fazën e gjykimit³⁰.



Prokuroria Themelore	Kallëzime penale	Aktakuza
Pejë	80	63
Prizren	46	34
Gjakovë	35	28
Mitrovicë	19	9
Ferizaj	4	3
Gjilan	0	0
Gjithsej	184	137

Burimi: Të dhënat e siguruar nga shtatë Prokuroritë Themelore në Kosovë, qershor për periudhën 2023-2025

30 Të dhëna zyrtare të siguruar përmes përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike nga shtatë Prokuroritë Themelore në Kosovë, qershor 2026.

Megjithatë, mënyra se si përfundojnë këto raste në procedurë gjyqësore është më e vështirë të vlerësohet. Kjo sepse rastet e shfrytëzimit ilegal të rërës dhe zhavorrit nuk evidentohen si kategori e veçantë në SMIL³¹. Për këtë arsye, për këtë analizë janë shqyrtuar aktgjykime për veprën penale të dëmtimit të mjedisit dhe janë zhvilluar intervista me institucionet përgjegjëse. Gjetjet tregojnë se sfidat kryesore lidhen me gjobat e ulëta, konfiskimin dhe sekuestrimin e mjeteve, si dhe me vlerësimin e dëmit ekologjik.

Gjobat dhe efekti i tyre parandalues. Një nga shqetësimet kryesore lidhet me lartësinë e dënimeve të shqiptuara. Gjatë hulumtimit u evidentua se gjobat shpesh janë të ulëta në raport me dëmin e shkaktuar dhe përfitimin ekonomik që mund të realizohet nga aktiviteti ilegal. Kjo vërehet edhe në aktgjykimet e shqyrtuara, ku në disa raste janë shqiptuar gjoba prej vetëm 250 deri në 300 euro, pavarësisht se bëhet fjalë për eksploatim të kundërligjshëm të materialit mineral, siç ilustron në aktgjykimet P.nr.407/2023 dhe P.nr.567/2023 të Gjykatës Themelore në Prizren.³²

Në raste të tjera, ku në aktgjykime është konstatuar edhe vlera monetare e dëmit, disproporcioni ndërmjet dëmit të shkaktuar dhe gjobës së shqiptuar bëhet edhe më i dukshëm. Për shembull, në aktgjykimin P.nr.542/22 të Gjykatës Themelore në Pejë, për eksploatimin e kundërligjshëm të rërës dhe zhavorrit, me ç'rast u konstatua dëm në vlerë prej 5,034.19 euro, personit përgjegjës iu shqiptua gjobë prej vetëm 600 euro. Po ashtu, në aktgjykimin P.nr.2021:187897 të së njëjtës gjykatë, ku u konstatua dëm në vlerë prej 1,524.76 euro, u shqiptua gjobë prej vetëm 500 euro.³³

Ndërkaq, në aktgjykimin P.nr.1063/22 të Gjykatës Themelore në Prizren, për eksploatimin e kundërligjshëm të rërës dhe zhavorrit, me ç'rast u konstatua dëm material dhe mjedisor në vlerë prej 1,349.86 euro, personit përgjegjës iu shqiptua gjobë prej vetëm 400 euro. Po ashtu, në aktgjykimin P.nr.1129/2023 të së njëjtës gjykatë, për eksploatimin e kundërligjshëm të rërës dhe zhavorrit, me ç'rast u konstatua dëm material dhe dëm ekologjik, personit juridik iu shqiptua gjobë prej vetëm 500 euro.³⁴

Gjithashtu, në aktgjykimin P.nr.140/25 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, i pandehuri evidentohet si person i dënuar më parë (recidivist), çka sugjeron se dënimet e mëparshme nuk kanë qenë gjithmonë të mjaftueshme për të parandaluar përfshirjen e tij të përsëritur në procedura penale³⁵.

Në disa raste operatorët kanë vazhduar aktivitetin edhe pas shqiptimit të gjobave, derisa janë konfiskuar pajisjet dhe mjetet e punës³⁶. Kjo tregon se, në praktikë, gjobat e ulëta nuk kanë qenë gjithmonë të mjaftueshme për t'i dekurajuar shkelësit që ta përsërisin të njëjtin aktivitet ilegal.

Konfiskimi dhe sekuestrimi i mjeteve. Një nga vështirësitë kryesore në trajtimin e këtyre rasteve lidhet me konfiskimin e mjeteve të përdorura për shfrytëzimin ilegal të rërës dhe zhavorrit. Edhe kur prokuroria kërkon konfiskimin e ekskavatorëve ose kamionëve, gjykatat nuk i miratojnë gjithmonë këto kërkesa. Për shembull, në aktgjykimin P.nr.49/2026 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, gjykata refuzoi konfiskimin e një ekskavatori dhe një kamioni, duke vlerësuar se vlera e tyre ishte joproporcionale në raport me dëmin e konstatuar. Çështje që lidhen me konfiskimin e mjeteve janë trajtuar edhe në aktgjykimet P.nr.190/25 dhe P.nr.1293/2023 të Gjykatës Themelore në Prizren³⁷.

31 Përgjigje e Gjykatave Themelore në Kosovë të siguruara përmes përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, qershor 2026.

32 Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.407/2023, i datës 25.07.2023; Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.567/2023, i datës 30.01.2024.

33 Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.542/22, 7 dhjetor 2025; Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.2021:187897, 07.04.2023.

34 Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1063/22, 21 maj 2024; Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1129/2023, 28.12.2023.

35 Aktgjykimi P.nr.140/25, datë 04.11.2025, Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec.

36 Intervistë me Adem Berishën, U.D. Kryeinspektor i Departamentit për Mjedis dhe Elbasan Shalën, Udhëheqës i Divizionit, Departamenti i Inspektoratit për Mjedis, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, 15.05.2026.

37 Aktgjykimet: P.nr.49/2026, datë 20.05.2026, Gjykata Themelore në Gjakovë, P.nr.190/25, datë 20.04.2026, Gjykata Themelore në Prizren; dhe P.nr.1293/2023, datë 16.12.2024, Gjykata Themelore në Prizren.

Vështirësi paraqiten edhe në zbatimin e sekuestrimit. Deri më tani janë sekuestruar rreth 10 kamionë, me vlerë të përgjithshme rreth 250,000 euro³⁸. Procedurat nga sekuestrimi deri në vendimin përfundimtar të gjykatës zgjasin zakonisht nga 4 deri në 7 vjet³⁹.

Ligji për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar parasheh mundësinë që mjetet e sekuestruara të shiten edhe para përfundimit të procedurës gjyqësore, në rastet kur ato rrezikojnë të humbin vlerën ose kur ruajtja e tyre shkakton kosto të larta⁴⁰. Në këto raste, të ardhurat nga shitja ruhen deri në përfundimin e procedurës gjyqësore. Mirëpo, edhe pse kjo mundësi parashihet me ligj, ende nuk po shfrytëzohet në praktikë.

Edhe pas sekuestrimit hasen vështirësi praktike. Transportimi i mjeteve të rënda kërkon angazhimin e operatorëve të specializuar dhe shoqërohet me kosto të larta. Në një rast, transporti i një makinerie nga Zveçani në Prishtinë ka kushtuar rreth 3,500 euro. Po ashtu, në disa raste mjetet dëmtohen qëllimisht para sekuestrimit, duke e bërë edhe më të vështirë transportimin dhe ruajtjen e tyre⁴¹. Si pasojë, mjetet e përdorura për aktivitetet ilegale nuk largohen gjithmonë nga përdorimi në kohë, duke e zbehur efektin parandalues të konfiskimit.

Vlerësimi i dëmit ekologjik. Këto vështirësi reflektohen edhe në mënyrën se si vlerësohet dëmi gjatë procedurës gjyqësore. Vëmendja përqendrohet kryesisht te dëmi ekonomik, ndërsa ndikimi afatgjatë në lumenj dhe ekosistemet e tyre nuk reflektohet gjithmonë në mënyrë të plotë. Kështu, dëmi ekologjik nuk pasqyrohet gjithmonë në masën e sanksioneve që shqiptohen⁴².

Edhe kur gjykata konstaton se shfrytëzimi ilegal ka shkaktuar dëm ekologjik, kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht se ai reflektohet në masën e dënimit. Për shembull, në aktgjykimin P.nr.1063/22 të Gjykatës Themelore në Prizren u konstatua dëm material dhe mjedisor në vlerë prej 1,349.86 euro, ndërsa personit përgjegjës iu shqiptua një gjobë prej vetëm 400 euro. Po ashtu, në aktgjykimin P.nr.1129/2023 të së njëjtës gjykate u konstatua se aktiviteti ilegal kishte shkaktuar dëm material dhe dëm ekologjik, ndërsa personit juridik iu shqiptua gjobë prej vetëm 500 euro⁴³. Kjo tregon se pesha e dëmit ekologjik nuk reflektohet gjithmonë në mënyrë proporcionale në sanksionet e shqiptuara.

38 Intervistë me Alban Sutajn, U.D. Drejtor i Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, 03.06.2026.

39 Diskutim tematik me aktorë relevantë nga institucionet përgjegjëse dhe ekspertë të fushës, mbajtur më 16.07.2026.

40 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, neni 27, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=105952>

41 Intervistë me Arsim Krasniqin, Drejtor i Drejtorisë për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, Drejtoria e Hetimeve, Policia e Kosovës, 12.06.2026.

42 Intervistë me Egzona Shala-Kadiun, eksperte e mjedisit nga shoqëria civile, 20.05.2026. Ky konstatim mbështetet edhe nga analiza e aktgjykimeve P.nr. 1063/22 dhe P.nr. 1129/2023, të shqyrtuara në kuadër të këtij hulumtimi.

43 Gjykata Themelore në Prizren, Aktgjykimi P.nr.1063/22, 21.05.2024; Gjykata Themelore në Prizren, Aktgjykimi P.nr.1129/2023, 28.12.2023.

Rekomandime

Në tërësi, gjetjet e këtij hulumtimi tregojnë se sfida kryesore nuk qëndron te mungesa e legjislacionit, por te zbatimi efektiv i tij. Analiza tregon se dobësitë shfaqen përgjatë gjithë zinxhirit institucional të trajtimit të rasteve të shfrytëzimit ilegal të rërës dhe zhavorrit, nga monitorimi dhe inspektimi, te ndjekja penale, vendimmarrja gjyqësore dhe administrimi i mjeteve të sekuestruara ose të konfiskuara. Për këtë arsye, rekomandimet e mëposhtme synojnë të forcojnë secilën prej këtyre hallkave dhe të përmirësojnë bashkërendimin ndërmjet tyre.

Për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor:

- Të plotësohen kapacitetet e Inspektoratit të Mjedisit, Ujërave dhe Natyrës, përfshirë rritjen e numrit të inspektorëve të ujërave në përputhje me objektivat e Strategjisë Shtetërore të Ujërave, plotësimin e stafit profesional, administrativ dhe mbështetës, si dhe digjitalizimin e proceseve të inspektimit.
- Të funksionalizohet Këshilli Ndërmnistror për Ujëra, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Ligjin për Ujërat, me qëllim të forcimit të koordinimit ndërinstitucional dhe mbikëqyrjes së zbatimit të politikave në fushën e ujërave.
- Të miratohet plani për menaxhimin e shfrytëzimit të lumenjve dhe përcaktimi i segmenteve ku mund të lejohet nxjerrja e rërës dhe zhavorrit, në përputhje me Ligjin për Ujërat.

Për Policinë e Kosovës:

- Të forcohen kapacitetet e Njesisë për Hetimin e Krimeve Mjedisore në Policinë e Kosovës, përfshirë rritjen e numrit të hetuesve të specializuar dhe specializimin e hetuesve në nivel lokal për trajtimin e krimeve mjedisore.
- Të planifikohen kontrole të përbashkëta me Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave dhe Natyrës, në bazë të vlerësimit të rrezikut, duke përqendruar burimet në zonat ku shfrytëzimi ilegal i rërës dhe zhavorrit paraqitet më shpesh.

- Të rritet ndërgjegjësimi i qytetarëve për mekanizmat ekzistues të raportimit të krimeve mjedisore dhe të promovohet përdorimi i tyre.

Për Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK)

- Të forcohet bashkëpunimi me Policinë dhe Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave dhe Natyrës për mbledhjen dhe sigurimin e provave që dokumentojnë dëmin e shkaktuar nga shfrytëzimi ilegal.
- Të organizohen trajnime periodike për prokurorët lidhur me hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të shfrytëzimit ilegal të rërës dhe zhavorrit dhe krimeve mjedisore.
- Të inkurajohen prokurorët që, kur plotësohen kushtet ligjore, të kërkojnë në mënyrë konsistente konfiskimin e mjeteve.
- Në bashkëpunim me Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, të shfrytëzohen mundësitë ligjore për shitjen e mjeteve të sekuestruara në rastet kur ato rrezikojnë të humbin vlerën ose kur ruajtja e tyre shkakton kosto të larta.

Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK)

- Gjatë caktimit të sanksioneve të merret në konsideratë jo vetëm dëmi ekonomik, por edhe ndikimi afatgjatë në lumenj dhe ekosistemet e tyre.
- Të promovohet zbatim më konsistent masa e konfiskimit të mjeteve të përdorura në aktivitetet ilegale, kur plotësohen kushtet ligjore.
- Në bashkëpunim me gjykatat dhe institucionet përgjegjëse, rastet e shfrytëzimit ilegal të rërës dhe zhavorrit të klasifikohen si kategori e veçantë në Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), në mënyrë që të lehtësohet monitorimi, analizimi i praktikës gjyqësore dhe hartimi i politikave në këtë fushë.
- Të organizohen trajnime për gjyqtarët lidhur me trajtimin e krimeve mjedisore, me fokus në vlerësimin e dëmit ekologjik dhe zbatimin e masës së konfiskimit, kur plotësohen kushtet ligjore.

